

pro integra



**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
MIDIS
FONDIT SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN E DIASPORËS
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE
SHOQATËS “PRO INTEGRA”**

PREAMBUL

Diaspora shqiptare është një potencial i domosdoshëm edhe për zhvillimin e Shqipërisë, Kosovës dhe viseve tjera amë me anë të lidhjes dhe forcimit të bashkëpunimit ndërmjet komuniteteve të Diasporës dhe Shqipërisë, Kosovës dhe viseve tjera amë veçanërisht në fushën e ekonomisë, shkencës, arsimit, kulturës dhe çështjeve sociale. Diaspora ka kapacitete, të cilat mund të përdoren për zhvillimin e mëtëjshëm të shoqërisë shqiptare nëpërmjet ndërmjetësimit, përcjelljes së ideve/praktikave/vlerave dhe qëndrimeve, normave të sjelljes dhe kapitalit social.

Në këtë kuadër, **Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës (FSHZHD)** dhe Shoqata **“Pro Integra”** në Zvicër (në vijim referuar si “Palët”),

Duke vlerësuar rëndësinë e forcimit të bashkëpunimit ndërmjet Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, si institucion publik në Shqipëri, dhe Shoqatës “Pro Integra”, si organizatë jofitimprurëse dhe filantropike, e angazhuar në mënyrë aktive edhe në zhvillimin social-ekonomik e kulturor të Diasporës shqiptare në Zvicër;

Me dëshirën për të bashkëpunuar në kuadër të realizimit të projekteve që synojnë mbështetjen dhe nxitjen e zhvillimit socio-ekonomik e kulturor të shqiptarëve në Republikën e Shqipërisë, Republikën e Kosovës dhe jashtë saj, me anë të shkëmbimit të njohurive dhe burimeve në funksion të interesit të ndërsjellë të palëve;

Menaxhimi më i mirë i burimeve dhe kapitalit njerëzor të migrantëve dhe shoqërisë shqiptare në përgjithësi, krahas integritimeve ndërshtetërore në të gjitha fushat e mundshme bazuar edhe në shembullin dhe parimet themelore të integritimeve evropiane, ndër të tjera do të mundësonte që transmigrantët dhe rrjetet e diasporës të kontribuojnë më natyrshëm dhe më lehtë edhe në proceset e afrimit dhe integritimit të vendeve të prejardhjes në BE;

Bashkëpunimi i koordinuar dhe koherent midis vendeve të origjinës dhe vendeve nikoqire është gjithashtu i nevojshëm për të arritur një menaxhim efektiv dhe eficient të migracionit që përfshin të gjitha aspektet e politikës së migracionit dhe zhvillimit;

Me synimin për të koordinuar veprimtarinë e tyre duke i dhënë një rëndësi të veçantë punës për qëllimin madhor të përfshirjes së ekspertizës të anëtarëve të komunitetit të Diasporës shqiptare në të mirë të zhvillimit të vendit si dhe në drejtim të gjenerimit të ideve dhe nismave me përfitim të përbashkët;

Palët kanë rënë dakord të lidhin këtë Marrëveshje, në vijim e quajtur Marrëveshje Bashkëpunimi.

Neni 1

Objekti i marrëveshjes

Palët bashkëpunojnë me njëra-tjetrën dhe përpilojnë e zbatojnë plane konkrete për ndërtimin dhe krijimin e mekanizmave dhe strukturave të përbashkëta e të qëndrueshme, të koordinuara në shumë nivele, që përfshijnë të gjithë aktorët relevantë. Njëherazi palët angazhohen për njohjen e pranimin e pjesëtarëve të diasporës shqiptare si të tillë bashkë me kontributin tradicional të saj – përmes akteve juridike – si dhe përfshirjen institucionale të profesionistëve dhe rrjeteve (shoqatat, organizatat e ndërmarrjet si dhe grupet tjera të interesit) të diasporës shqiptare - veçanërisht personat transnacional - si subjekte aktive në politikbërje (ndër)shtetërore në vendin/et amë dhe atyre rezidente, me qëllim:

- a. Zhvillimin, plotësimin, zgjerimin dhe promovimin e Aktivitetit “Platforma Rrjeti i Profesionistëve Shqiptarë në Diasporë”
- b. Ofrimin e mbështetjes për fuqizimin e platformës “Rrjeti i Profesionistëve”;
- c. Organizimin e aktiviteteve, seminareve dhe konferencave të përbashkëta për sipërmarrjen, kulturën dhe vlerat shqiptare në diasporë;
- d. Krijimin e grupeve të punës për zbatimin e projekteve të përbashkëta në shpalljet e projekteve nga donatorët e ndryshëm.

Neni 3

Baza Ligjore

Pika 3 e Nenit 6 të Ligjit Nr 32/2018 “Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”;

Neni 60ff i Kodit Civil të Zvicrës për themelimin e Shoqatës jofitimprurëse “Pro Integra”.

Neni 4

Përgjegjësitë e palëve

Bashkëpunimi sipas kësaj marrëveshje do të funksionojë si vijon:

Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës do të realizojë:

- a. Zgjerimin dhe plotësimin me profesionistë, organizata dhe biznese shqiptare në Diasporë të platformës digjitale të “Rrjetit të Profesionistëve”;
- b. Bashkërendimin e punës për ekspertizë në ngritjen, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e platformës digjitale të “Rrjetit të Profesionistëve” me qëllim shkëmbimin e informacioneve dhe gjithëpërfshirjen e anëtarëve të komunitetit profesional të Diasporës në drejtim të gjenerimit të ideve dhe nismave me përfitim të përbashkët.
- c. Bashkërendimin e punës me Shoqatën “Pro Integra” për hartëzimin e profesionistëve, organizatave dhe bizneseve shqiptare në Diasporë duke i mundësuar bashkëpunimet përtej barrierave gjeografike dhe duke informuar mbi mundësi punësimi, investimi, pjesëmarrje në trajnime, etj.
- d. Realizimin e aktiviteteve në bashkëpunim me Shoqatën “Pro Integra” për promovimin e zhvillimit ekonomik dhe socio-kulturor të vendit dhe komunitetit të Diasporës shqiptare.

Shoqata “Pro Integra” e njohur edhe si Qendër profesionale për migracion (prointegra.ch) me një përvojë shumëvjeçare në Zvicër do të realizojë:

- a. Mbështetje për informacione të nevojshme për zhvillimin dhe zgjerimin e platformës;
- b. Bashkërendimin e punës me Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës për hartëzimin dhe rrjetëzimin e e profesionistëve, organizatave dhe bizneseve shqiptare në Diasporë;
- c. Realizimin e aktiviteteve në bashkëpunim me Shoqatën “Pro Integra” për promovimin e zhvillimit ekonomik dhe socio-kulturor të vendit dhe komunitetit të Diasporës shqiptare.

Neni 5

Konfidencialiteti dhe Pronësia Intelektuale

1. Palët detyrohen reciprokisht për kufizimet e fshehtësisë në lidhje me informacionin, të dhënat dhe

njohuritë që ata do të shkëmbejnë gjatë ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje, me përjashtim të atij informacionit, të dhënave, lajmeve dhe vendimeve për të cilat ligji ose një urdhër administrativ apo gjyqësor imponon një detyrim për të komunikuar dhe/ose për të marrë miratimin e palës nga e cila vijnë këto të dhëna;

2. Çdo e drejtë e pronësisë intelektuale në pronësi të një Pale do të mbetet në pronësi të plotë të saj dhe përdorimi i saj që i lejohet palëve të tjera sipas kësaj marrëveshje nuk do të nënkuptojë njohjen e ndonjë licence apo të drejte në lidhje me këtë të drejtë, me përjashtim të rasteve kur transferimi i kësaj licence ose të drejte është parashikuar në aktet operative;
3. Çdo e drejtë e pronësisë intelektuale në pronësi të një pale mund të përdoret nga palët e tjera për aktivitetet e përmendura në këtë marrëveshje vetëm me pëlqimin e shprehur të palës në pronësi të së cilës është kjo e drejtë edhe në përputhje me rregullat e treguara nga ajo palë dhe/ose përfshihet në Marrëveshje.

Neni 6

Të dhënat personale

Palët lejojnë përpunimin e të dhënave të tyre personale në përputhje me legjislacionin aktual për mbrojtjen e të dhënave personale; të njëjtat të dhëna mund të përfshihen në bazat e të dhënave, skedarët kompjuterik dhe sistemet telematike vetëm për qëllimet që lidhen me këtë Marrëveshje.

Neni 7

Zbatimi i marrëveshjes

Palët marrin përsipër të vlerësojnë bashkërisht zbatimin e marrëveshjes nëpërmjet hartimit dhe paraqitjes së një raporti me shkrim, në përfundim të aktiviteteve/projekteve në bashkëpunim.

Neni 8

Komunikimi mes palëve

1. Palët angazhohen të mbajnë një komunikim të vazhdueshëm ndërmjet tyre dhe të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e detyrave të tyre;
2. Komunikimi do të kryhet në formë shkresore ose në rrugë elektronike. Në çdo rast të paraqitjes së një kërkesë, palët angazhohen të japin përgjigje brenda 10 ditëve;
3. Palët angazhohen të jenë të disponueshme në çdo kohë për komunikimin me njëra-tjetrën me qëllim koordinimin e veprimeve që duhet të ndërmerren bashkërisht rast pas rasti.

Neni 9

Kostot financiare

Kostot financiare që rezultojnë nga zbatimi i kësaj Marrëveshjeje i nënshtrohen legjislacionit në fuqi dhe janë brenda kufijve të shpenzimeve buxhetore që palët kanë në dispozicion.

Neni 10

Kohëzgjatja dhe ndryshimi

Kjo marrëveshje nënshkruhet për një afat kohor të pacaktuar. Ajo mund të ndryshojë vetëm me marrëveshje të palëve nëpërmjet shkëmbimit të komunikimit me shkrim.


Neni 11

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e këtij memorandumi zgjidhet me mirëkuptim mes palëve.

Neni 10

Hyrja në Fuqi



Marrëveshja hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij dhe publikohet në faqet zyrtare të Palëve.

Marrëveshja hartohet 2 kopje për secilën palë dhe firmoset sot, datë _____ në _____.

PËR PRO INTEGRA
PRESIDENTI

PËR FSHZHD-në
DREJTORI EKZEKUTIV

